Nënshkrimi i Protokollit të Ripranimit
(8 prill 2013)

Fjalimi i Ambasadores

* *
*

Zoti Ministër

Zonja dhe zotërinj,

[Siç e tha ministri i Brendshëm], jemi mbledhur sot këtu për nënshkrimin e protokollit të ripranimit mes Francës dhe Shqipërisë, si një vazhdim, në kuadrin dypalësh, të marrëveshjes së ripranimit mes Bashkimit Evropian dhe Shqipërisë, nënshkruar më 14 prill 2005 (hyrë në fuqi më 1 maj 2006).

Ky Protokoll saktëson modalitetet praktike që do të zbatohen për organizimin e kthimit në Shqipëri të qytetarëve shqiptarë me qëndrim të paligjshëm në territorin francez.

Marrëveshja e ripranimit BE-Shqipëri dhe protokolli i ripranimit Francë-Shqipëri kanë të bëjnë me kuadrin e liberalizimit të vizave afatshkurtra, i cili zbatohet që prej 1 dhjetorit 2010.

Liberalizimi i vizave, i cili u mundëson qytetarëve shqiptarë të udhëtojnë pa viza për afate të shkurtra në hapësirën Shengen, ka qenë një masë shumë e rëndësishme, e cila është pritur me një gëzim të justifikueshëm dhe të madh nga shqiptarët. Në sajë të kësaj mase dhjetëra mijëra qytetarë shqiptarë të të gjitha moshave kanë pasur mundësinë që prej dy vitesh të zbulojnë Evropën, realitetin dhe diversitetin e saj.

Ky afrim njerëzor ka qenë një etapë shumë e rëndësishme për afrimin e Shqipërisë me Bashkimin Evropian.

Franca e ka mbështetur këtë liri të fituar nga Shqiptarët, e cila i ka zhvilluar edhe më tej marrëdhëniet franko-shqiptare në të gjitha fushat.

Por fatkeqësisht një numër i caktuar shqiptarësh nuk i respektojnë kushtet e kësaj lirie qarkullimi si për sa i përket kohëzgjatjes të qëndrimit ashtu dhe aktiviteteve të bërë gjatë këtij qëndrimi.

Ne kemi vënë re se edhe në Francë, fatkeqësisht, numri i shtetasve shqiptarë me qëndrim të paligjshëm është në rritje të konsiderueshme që prej verës së vitit 2012.

Nuk është e mundur të lejojmë që këta persona me qëndrim të paligjshëm, të rrezikojnë një liri, nga e cila përfitojnë me ndershmëri shumica e udhëtarëve shqiptarë. Këtë gjë nuk e dëshirojnë as autoritetet franceze dhe as ato shqiptare.

Përkundrazi, qëllimi i tyre i përbashkët është të intensifikojnë luftën kundër atyre që nuk respektojnë kushtet, me qëllim që të mbrojnë sa më mirë interesat e qytetarëve që respektojnë ligjin.

Kjo është arsyeja për të cilën qeveria franceze, të cilën unë përfaqësoj, dhe qeveria shqiptare po nënshkruajnë sot këtë protokoll. Duke u mbështetur në bashkëpunimin e shkëlqyer që ekziston tashmë mes policive të dy vendeve, ky protokoll do të ndihmojë që procedurat e ripranimit të jenë më të sakta, më sistematike dhe më të shpejta.